



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**NJOFTIM**

Ju lutemi, gjeni më poshtë njoftimin e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës, e cila do të zhvillohet ditën e **Enjte datë 27 Qershor 2024, ora 16:00**, në sallën e Këshillit Bashkiak.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në zbatim të nenit 53 të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ju përcjell për shqyrtim dhe diskutim, pikat e rendit të ditës, si më poshtë:

1. Projektvendim “Për miratimin e familjeve aplikuese që përfitojnë nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind, nga fondi i kushtëzuar dhe nga buxheti i Bashkisë Tiranë, për periudhën 1- 31 maj 2024”.
2. Projektvendim “Për ofrimin e një pakete higjienike për gratë dhe vajzat në ndihmë ekonomike, banore në Bashkinë e Tiranës”. *(propozim i një grupi këshilltarësh)*
3. Projektvendim “Për mbështetjen e studentëve shqiptarë që janë pranuar për të studiuar pranë Kolegjit të Evropës në Tiranë”.
4. Projektvendim “Për sistemimin e Fatjon Hoxha në banesat sociale me qira, Shkozë”. *(propozim i një grupi këshilltarësh)*
5. Projektvendim “Për miratimin e listave të përfituesve të programeve të procesit të rindërtimit”.
6. Projektvendim “Për miratimin e bonusit të qirasë të individëve/familjeve, pasuritë e të cilëve preken nga zbatimi i projektit të segmentit rrugor “Unaza e madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri, Shkozë”.
7. Projektvendim “Për miratimin e subvencionit të qirasë të disa familjeve në nevojë, që nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë”.
8. Projektvendim “Për miratimin e kompensimit ushqimor për nxënësit që ndjekin arsimin bazë, në shkollat publike ku zbatohet projekti “Bëjmë detyrat e shtëpisë”.
9. Projektvendim “Për miratimin e Këshillit Artistiko-Kulturor pranë Bashkisë Tiranë për vitet 2024-2026 dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”.
10. Projektvendim “Për zhvillimin e pronave nr. 7/87 (pjesërisht), 7/292, 7/26, 7/41, 7/295, 7/70 dhe nr. 7/57, zona kadastrale 8330, në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe miratimin e draft kontratës së sipërmarrjes me kusht shkëmbimi midis Bashkisë Tiranë dhe shoqërisë “StarTek” sh.p.k.”
11. Projektvendim “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të sipërfaqes, pjesë e pasurisë nr. 77, zona kadastrale 2380, që do të përdoret për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në fushën e shërbimit të varrimit dhe të pasurisë

me nr. 8/580, zona kadastrale 8180, që do të përdoret për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në fushën e arsimit”.

12. Projektvendim “Për dhënien në përdorim pa kundërshpërblim në favor të Kolegjit të Evropës, të objektit “Godina nr. 3”, me nr. pasurie 5/542, ndodhur në zonën kadastrale 8160”.

13. Projektvendim “Për miratimin e marrëveshjes së nënhuasë midis ministrisë së Financave dhe shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë për “Kontratën financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për programin “Ukt shpërndarja e ujit”.

14. Projektvendim “Për miratimin e projektit “Fuqizimi i grave dhe nxitja e sipërmarrjes”, hartuar sipas udhëzuesit operacional për zbatimin e tij”.

15. Projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 41, datë 23.09.2015, të Këshillit Bashkiak, “Për riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”, të ndryshuar”.

16. Projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin nr. 125, datë 22.12.2023, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024, të ndryshuar”.

17. Projektvendim “Për miratimin e projektdokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025 – 2027”.

18. Projektvendim “Për miratimin e raportit të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të Bashkisë Tiranë për 12 mujorin e vitit 2023”.

Ju faleminderit,

Romina Kuko

Kryetare e Këshillit Bashkiak

*Materialet e pikës 18 të rendit të ditës janë dërguar me email në datë 3 qershor 2024.*

## **MBLEDHJET E KOMISIONEVE**

**Komisioni i Edukimit dhe Infrastrukturës Arsimore**, do të shqyrtojë pikën 3,8 dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e hënë, datë 24 qershor, ora 12:00.

**Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese dhe Nxitjes së Sipërmarrjes**, do të shqyrtojë pikën 14 dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e hënë, datë 24 qershor, ora 13:00.

**Komisioni i Financave dhe Buxhetit**, do të shqyrtojë pikat 1,2,3,5,6,7,8,13,14,16,17,18 dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e martë, datë 25 qershor, ora 10:30.

**Komisioni i Çështjeve Ligjore dhe Drejtësisë Sociale, do të shqyrtojë pikat 2,4,8,10,11,12,13,14,15 dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e martë, datë 25 qershor, ora 13:30.**

**Komisioni i Kulturës, Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore, do të shqyrtojë pikën 9 dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e mërkurë, datë 26 qershor, ora 12:00.**